



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

10.05, 2022

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

THIRRJE PUBLIKE

10-451-14502/22

Duke u bazuar në “Rregullore MF – NR – 04/2017 të datës 21.06.2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve” Komuna e Klinës – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport rishpall:

Thirrje publike – për mbështetje financiare për vitin 2022, për të gjitha organizatat joqeveritare që veprojnë në komunën e Klinës, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Data e hapjes së thirrjes 10.05.2022

Afati i fundit për aplikim 18.05.2022

1. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte/programe të tyre në fushat si në vijim:

- Në fushën e kulturës, ku synohet:
 - Promovimi, afirmimi dhe rritja e aktiviteteve që vë në pah vlerat kulturore.
 - Promovimi i objekteve me rëndësi të veçantë të Trashëgimisë Kulturore.
 - Zhvillimi i krijimtarisë artistike në fusha të ndryshme arti.
 - Zhvillimin e turizmit lokal.
 - Aktivitete të ndryshme kulturore për shënimin e datave të rëndësishme.
- Në fushën e rinisë, ku synohet:

- Zhvillim i aktiviteteve rinore dhe fuqizimi i të rinjëve.
 - Mobilizimi i të rinjëve në realizimin e projekteve që ndikojnë në sigurinë, mbrojtjen e të drejtave, informacionin dhe aftësimin e të rinjëve ndaj dukurive negative shoqërore.
 - Mbështetje e qendrave rinore dhe grupeve rinore që veprojnë në Komunën e Klinës.
 - Trajnime, konferenca e sesione informuese që ndihmojnë drejtimin në karrierë.
- Në fushën e sportit, ku synohet:
 - Aktivizimi i sportistëve të rinj e të talentuar.
 - Përkrahja, ngritja e nivelit profesional dhe zhvillimi i klubeve sportive.
 - Përfaqësim i dinjitetshëm dhe i suksesshëm për komunën e Klinës në fushën e sportit.

2. Kushtet formale të thirrjes:

- Të drejtë aplikimi kanë:
 - OJQ-të dhe klubet sportive veprimtaria e të cilave është e fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit në Komunën e Klinës.
 - OJQ-të që janë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike.
 - Klubet sportive që janë të regjistruara në federata të sporteve përkatëse.
 - OJQ-të që kanë sjell raport të rregullt financiar dhe i kanë kryer të gjitha obligimet e kërkuara nga DKRS-ja për llogaridhënie dhe raportim në shfrytëzimin e fondeve publike, në përputhje me nenin 4 të rregullores së MF-nr- 04/2017 (pika 1.6).
- Nuk kanë të drejtë aplikimi:
 - OJQ-të dhe klubet e falimentuara.
 - Aplikuesit që nuk i kanë përmbyllur obligimet paraprake ndaj DKRS-së.
 - Klubet dhe OJQ-të që nuk janë të Komunës së Klinës.

3. Mënyra si të aplikoni, dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit – forma e projektit
- Formulari 10 – Forma e buxhetit
- Dokumenti identifikues (kopje)
- Certifikatë që dëshmon për regjistrimin e OJQ-së në Ministrinë e Administratës (kopje)

- Certifikatë e numrit fiskal (kopje) – të jetë me seli në Klinë, nëndegën në Klinë
 - Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit
 - Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik)
- Formularët për aplikim i gjeni në web-faqen e Komunës së Klinës apo në zyrat e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
 - **Afati i aplikimit është 7 ditë pune nga dita e shpalljes, duke filluar nga data 10.05.2022 deri më 18.05.2022.**
 - **Aplikacionet e plotësuara duhet të dorëzohen personalisht nga aplikuesi, të jenë të vendosura në zarf dhe të protokolohehen në arkivin komunal.**

4. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projektet

- **Shuma e paraparë për ndarjen e mbështetjes financiare në total është 60.000 €.**
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga fusha e kulturës – për projektet është 300€ ndërsa shuma maksimale 5000 €.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga fusha e rinisë – për projektet është 300€ ndërsa shuma maksimale 5000€.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga fusha e sportit– për projektet është 300€ ndërsa shuma maksimale 32000€.

5. Komisioni vlerësues dhe mënyra e vlerësimit

- Në përputhje me rregulloren, komisioni vlerësues do të përbëhet nga pesë anëtarë.
- Vlerësimi bëhet nga plotësimi i kushteve administrative të aplikimit.
- Ndërlidhja me objektivat e thirrjes.
- Kapaciteti i dëshmuar organizativ dhe udhëheqës.
- Mbështetja financiare e klubeve sportive do të bëhet sipas pjesëmarrjes së tyre në nivelet garuese dhe sukseset e klubit.
- Vazhdimësisë së realizimit të programit dhe qëndrueshmërisë së tij.
- Raporti i komisionit vlerësues mbi raportet financiare të OJQ-ve për subvencionim në vitin e kaluar.

Vërejtje:

1. Aplikacionet që dorëzohen pas afatit të paraparë nuk pranohen.
2. Të gjithë aplikuesit që nuk e kanë të kompletuar dokumentacionin e kërkuar, nuk do të vlerësohen dhe nuk do të merren parasysh.

Njoftim për aplikuesit:

1. Të gjithë aplikuesit, aplikimet e të cilëve hyjnë në procesin e vlerësimit do të informohen në lidhje me vendimin e ndarjes buxhetore për projektet e pranuar.
2. Të gjithë aplikuesit, aplikimet e të cilëve nuk kanë qenë të kompletuara dhe refuzohen, do të informohen për arsyen e refuzimit në përputhje me kriteret e kërkuara dhe rregulloren.

KLINË

Data: 10.05.2022

Drejtoreshë: Fatjona GASHI

